



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BORDI I MBIKËQYRJES PUBLIKE

**KRITERET DHE DOKUMENTAT PËR HARTUES TË PROVIMEVE TË AFTËSIVE
PROFESIONALE**

Njoftohen të gjithë të interesuarit për të aplikuar si hartues të provimeve të aftësive profesionale në disiplinat:

- “Procedurat e punës për auditimin e pasqyrave financiare, sipas kërkesave të standardeve ndërkombëtare të auditimit”- datë 16 janar 2021;
- “Zbatimi i modeleve të duhura të organizimit dhe drejtimit, kontrolli i brendshëm i njësive ekonomike të biznesit dhe përdorimi i sistemeve të informacionit dhe të informatikës”- datë 30 janar 2021;
- “Qeverisja e shoqërive tregtare dhe zbatimi në praktikë i kërkesave të etikës profesionale dhe të biznesit”- datë 13 shkurt 2021.

Kriteret që duhet të plotësojnë hartuesit janë si më poshtë:

Hartuesit duhet të plotësojnë kërkesat e mëposhtme:

- i. Diplomë “Master i Shkencave” ose “Master i Arteve” apo të barazvlefshme me to sipas legjislacionit të arsimit të lartë, dhe 7 vite përvojë pune në fushën përkatëse, ose
- ii. Gradë apo titull shkencor apo të barazvlefshme me të, sipas legjislacionit të arsimit të lartë dhe minimalisht 5 vite përvojë pune në fushën përkatëse;
- iii. Si dhe përvec pikës i ose pikës ii, aftësi për të hartuar teste dhe aftësi për të hartuar dhe zgjidhur në mënyrë pragmatike rastet studimore.

Kërkesa drejtuar Komisionit të Provimeve të Aftësisë Profesionale së bashku me dokumentacionin shoqërues do të dorëzohet pranë sekretarisë teknike pranë organizatës profesionale IEKA (një kopje e kërkesës së bashku me dokumentacionin dorëzohet pranë Strukturës Mbështetëse të BMP në rrugë postare ose elektronike).

Dokumentacioni që duhet dorëzuar:

Çdo kandidat që aplikon për hartues duhet të paraqesë zyrtarisht dokumentacionin e mëposhtëm pranë sekretarisë teknike të KPAP-së, si dhe një kopje e cila vihet në dispozicion të Strukturës Mbështetëse të BMP-së:

- a. Kërkesë me shkrim për pozicionin që po aplikon;
- b. Curriculum Vitae;



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BORDI I MBIKËQYRJES PUBLIKE

- c. Referencë ose dokument zyrtar për të vërtetuar përvojën në fushën përkatëse për të cilën po aplikon;
- d. Fotokopje të diplomave;
- e. Çertifikatën e gjendjes gjyqësore (informacion për rekorde penale).

Të gjithë hartuesit do të jenë subjekt i verifikimit për përmbushjen e kërkesave ligjore dhe kuadrit rregullator.

Shënim*

Afati i dorëzimit të dokumentacionit të kandidatëve për hartues për provimin e katërt të datës 16.01.2021 për disiplinën “Procedurat e punës për auditimin e pasqyrave financiare, sipas kërkesave të standardeve ndërkombëtare të auditimit”, do të jetë deri më **datë 08.01.2021 ora 14:00;**

Afati i dorëzimit të dokumentacionit të kandidatëve për hartues për provimin e pestë të datës 30.01.2021 për disiplinën “Zbatimi i modeleve të duhura të organizimit dhe drejtimit, kontrolli i brendshëm i njësive ekonomike të biznesit dhe përdorimi i sistemeve të informacionit dhe të informatikës”, do të jetë deri më **datë 13.01.2021 ora 14:00;**

Afati i dorëzimit të dokumentacionit të kandidatëve për hartues për provimin e gjashtë të datës 13.02.2021 për disiplinën “Qeverisja e shoqërive tregtare dhe zbatimi në praktikë i kërkesave të etikës profesionale dhe të biznesit”, do të jetë deri më **datë 22.01.2021 ora 14:00.**